



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.09.2021*

prezantuar, paraqitur në KQZ, nuk rezulton që nga kandidati për deputet i Partisë Socialiste, zoti Alfred Muharremi të jetë zhvilluar veprimtari elektorale. Ajo çfarë, qoftë dhe pala denoncuese prezantoi, rezulton që aktiviteti i zhvilluar në ambientet e bibliotekës “Misto Treska” ka qenë thjesht dhe vetëm i karakterit informativ. Nuk ka patur asnjë ftesë për të votuar atë si kandidat, por edhe subjektin zgjedhor të cilin ai përfaqëson. Nga përfaqësuesit e organizatës nuk u paraqit asnjë provë për të provuar faktin që aty është zhvilluar aktivitet elektorale, sikurse edhe vetë kandidati prezantoi, por edhe përfaqësuesi i qendrës konfirmoi. Aktiviteti aty ka qenë thjesht dhe vetëm me karakter informativ dhe prezantues të kandidatit, jo në cilësinë e tij si kandidat për deputet. Prandaj bazuar në nenin 19 pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” dhe pika 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos përfundimin e shqyrtimit administrativ për denoncimin e bërë ndaj kandidatit për deputet, zotit Alfred Muharremi, Bashkisë Tirane dhe subjektit zgjedhor, Partia Socialiste. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Vendimi nr. 451**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.21.09.2021*

konsiderohet një veprimtari në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Edhe vetë drejtori i shkollës “Shëmri” Kukës pranoi faktin që aktiviteti është zhvilluar edhe pse jo në ambientet e brendshme të shkollës, është zhvilluar në territorin dhe në oborrin e shkollës. Për këtë arsye bazuar në nenin nr. 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, si dhe neni 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos të marrë masën administrative për dënim me gjobë për drejtorin e shkollës së mesme “Shëmri” Kukës në vlerën e 5.000 (pesë mijë) lekëve. Ky vendim përbën titull ekzekutiv. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Çështje të tjera në rend dite? Nuk kemi! Mirë, seanca mbyllet, faleminderit.

**Vendimi nr.452**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

